



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 980, datë 2.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES
DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Caktimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, si njësi zbatuese, për projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT).
2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, nga njësia zbatuese, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në masën 275 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit.
3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.
4. Fondi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i shtohet Ministrisë së Brendshme, në programin “Planifikim menaxhim”, për Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara.

5. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.
6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ



NR.PROT. 6101/1
DATË 3. 12. 2020

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

